



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 25 shkurt 2011
Nr. ref.: RK 86/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 34/10

Parashtruesi

Bislim Kosumi

vs.

Gjykatës Komunale në Podujevë

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Bislim Kosumi, me banim në Podujevë.

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesi i kërkesës i konteston këto vendime:
 - a. Vendimin e Gjykatës Komunale në Podujevë, C. nr. 186/86, të 17 prillit 1986;
 - b. Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 444/1986, të 11 korrikut 1986;
 - c. Vendimin e Sekretariatit Krahinor të Ekonomisë në Prishtinë, 05 nr. 313-500/87, të 8 tetorit 1987;
 - d. Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 1234/86, të 13 shkurtit 1987;
 - e. Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Gz. nr. 350/1987, të 6 tetorit 1987; dhe
 - f. Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 1393/1987, të 15 marsit 1988.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës kërkon “rishikimin e (...) akteve gjyqësore dhe një urdhër-rekomandim nga kjo Gjykatë që bazuar në aktet e sipërpërmendura gjyqësore të konfirmohet e drejta ime e pronësisë dhe kjo e drejtë të ekzekutohet nga organet kompetente komunale në Podujevë, dmth. nga shërbimet për kadastrë dhe çështje urbane”. Ai pretendon se i është shkelur e drejta e tij e pronësisë.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi i kërkesës dorëzoi një kërkesë më 29 janar 2010. Megjithatë, ajo u regjistrua nga Sekretariati i Gjykatës vetëm më 22 mars.
6. Kërkesa iu komunikua Gjykatës Komunale në Podujevë më 22 mars 2010, e cila u përgjigj më 7 shtator duke thënë se Gjykata nuk i posedon vendimet të cilave u referohet parashtruesi i kërkesës pasi serbët i kanë marrë të gjitha dokumentet me vete pas luftës.
7. Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (Kryesues), Kadri Kryeziu dhe Gjyljeta Mushkolaj, e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues Almiro Rodrigues më 21 janar 2011, dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Parashtruesi i kërkesës bleu një foto-studio në Podujevë më 3 korrik 1985.
9. Më 11 prill 1986, parashtruesi i kërkesës ngriti padi pranë Gjykatës Komunale në Podujevë për vërtetimin e kontratës për blerjen e foto-studios. Më 17 prill 1986, Gjykata Komunale në Podujevë deklaroi se nuk ishte kompetente ta trajtonte këtë rast.
10. Parashtruesi i kërkesës e ngriti të njëjtën padi pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, e cila më 11 korrik 1986 vendosi që zyra komunale e gjeodezisë në Podujevë duhet ta kryejë bartjen e titullit të pronësisë tek parashtruesi i kërkesës.
11. Avokati publik, në cilësi të palës ndërhyrëse dhe duke përfaqësuar interesat e komunës së Podujevës, kërkoi nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë ta rishikonte vendimin e vet të 11

korrikut 1986. Megjithatë, më 30 mars 1987, Gjykata e Qarkut e hodhi poshtë si të papranueshme kërkesën e avokatit publik. Edhe ankesa kundër këtij vendimi pranë Gjykatës Supreme u hodh poshtë.

Pretendimet e parashtruesit

12. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta e tij e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës [Mbrojtja e Pronës] nga aktet e sipërpërmendura gjyqësore.
13. Ai më tej pretendon që “këto akte nuk janë pranuar apo ekzekutuar nga Gjykata Komunale dhe organet e saj në Podujevë” dhe se “procedurat janë ndërprerë, por aktgjykimi nuk është ekzekutuar”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

14. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
15. Të gjitha vendimet e sipërpërmendura, që pretendohet se ia kanë shkelur të drejtën e pronësisë, datojnë ndërmjet 17 prillit 1986 dhe 15 marsit 1988.
16. Prandaj, kërkesa e parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me një çështje që ka ndodhur para 15 janarit 2009, që është data e hyrjes në fuqi e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
17. Kërkesa është dashur të parashtrohej para 15 majit 2009 [*Në pajtim me dispozitat e kombinuara ligjore të nenit 49, 56 dhe 58 të Ligjit për Gjykatën.*]; megjithatë, kërkesa u parashtrua më 29 janar 2010.
18. Prandaj, rezulton që kërkesa është e paafatshme dhe, si e tillë, nuk është “*ratione temporis*” në pajtim me dispozitat e Kushtetutës dhe të Ligjit [*Shih Aktvendimin për papranueshmëri, Rasti KI 25/09 Shefqet Haxhiu kundër Organizatës së punës “Industria e akumulatorëve”, të 21 qershorit 2010, dhe Blečić kundër Kroacisë, Kërkesa nr. 59532/00, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 29 korrikut 2004.*].
19. Prandaj, kërkesa e parashtruesit hidhet poshtë si e papranueshme.

PËR KËTË ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOS


I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.

Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani